

VENDIM

Për Sekuestrim Pasurie

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e përbërë prej

GJYQTARE: Liljana BAKU

Asistuar nga sekretare séance **Andina Kaja**, sot në datë 11.06.2010, ora 11.00, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën penale Nr 08 Rregj. me:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga **prokuror Besnik Muçi**.

OBJEKTI: Sekuestrim i pasurive:

- 1- Një apartament banimi, me sipërfaqe 106 m², ndodhur në katin e shtatë të pallatit në rrugën XXXX , Tiranë, përfituar nga shtetësja B.L.K me Kontratën e Sipërmarrjes Nr. XXX Rep, Nr. XXX Kol, datë 28.10.2009 të lidhur më Shoqërinë XXX Sh.P.K, me administrator shtetasin M.S.
- 2- Një apartament, me sipërfaqe banimi 99 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 9.9 m², ndodhur në katin e tretë të një pallati në XXXX, së bashku me garazhin, përfituar nga shtetasi N.L.K me Kontratën e Sipërmarrjes Nr XXX Rep, Nr. XXX Kol, datë 06.07.2009, të lidhur me shoqërinë XXXX Sh.P.K, me administrator shtetasin P.K.
- 3- Një mjet, tip Ford, me targa XXXX, rregjistruar në emër të shtetasit M.N.K në datë 05.01.2010, në Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë.
- 4- Një llogari bankare, çelur pranë Bankës Popullore, me Nr. XXXX, në emër të shtetasit M.N.K, në shumën 301. 064 (treqind e njëmijë e gjashtëdhjetë e katër) lekë.Për ekzekutimin e vendimit të ngarkohen Zyrat e Përmbarimit në Tiranë dhe Kavajë dhe administratorët e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe

Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë,
M.H dhe I.D.

KUNDËR :

SHTETASIT NËN HETIM : M.K, lindur dhe banues Lushnjë
PERSONAVE TË TRETË:

- N.K, lindur dhe banues, Lushnjë.
- B.K, banuese ne Lushnje
-

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 10192
datë 03.12.2009 “Për parandalimin
dhe goditjen e krimit të organizuar dhe
trafikimit

nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Në përfundim të gjykimit gjykata, pasi e gjeti veten kompetente për të gjykuar dhe vendosur mbi kërkesën e paraqitur, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi dëgjoi pretendimin përfundimtar të prokurorit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

V Ë R E N

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në datë 03.05.2010, ka rregjistruar procedimin pasuror në ngarkim të shtetasit nën hetim M.N.K, si i dyshuar për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Ky procedim është rrjedhojë e procedimit penal Nr. XXX viti 2010, të rregjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë .

Nga materiali hetimor që Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka rezultuar se Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka informuar Policinë e Shtetit për një rast të dyshimtë të pastrimit të produkteve të

veprës penale nga shtetasit shqiptarë E dhe E.Z ,L.B, O.S, M.K dhe SC. Për këta shtetas Prokuroria e Athinës, është duke hetuar për shkelje të neneve 45, 94, 322 dhe 385 të Kodit Penal Grek që kanë të bëjnë me pengmarrje, kërcënim në bashkëpunim dhe armëmbajtje pa leje. Këto vepra penale janë kryer në periudhën kohore 19.06.2009-25.06.2009 dhe kanë lidhje me rrëmbimin e shtetases greke E.A.F. Gjatë periudhës së rrëmbimit, shtetasi grek A.S.TH, njëkohësisht mik i të dëmtuarës, ka bërë pagesën në kesh të shumës prej 1.800.000 euro me qëllim lirim të shtetases së marrë peng.

Oficeri i Kontaktit, në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Athinë, ka përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit Shkresën Nr. XXXXXX datë 02.02.2010 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të Greqisë, mbi ndalimin e disa shtetasve shqiptarë. Nga përmbajtja e shkresës ka rezultuar se kjo e fundit (Drejtoria e Policisë Greke) ka referuar pranë Prokurorisë së Athinës nisjen e procedimit penal në ngarkim të tetë të akuzuarve (prej të cilëve gjashtë shtetas shqiptarë), për shkelje të neneve 45, 94, 322 dhe 385 të Kodit Penal Grek, në lidhje me rrëmbimin e shtetases greke E.F. Ndërmjet shtetasve për të cilët është urdhëruar ndalimi rezulton shtetasi M.K, për të cilin është shpallur kërkim ndërkombëtar.

Nga të dhënat e marra në Sistemin TIMS mbi hyrje-daljet e shtetasit M.K ka rezultuar se ky shtetas, së bashku me bashkëshorten e tij B.K, ka hyrë në Republikën e Shqipërisë në datë 25.06.2009 ora 22.06 nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar Kakavijë. Data e hyrjes së shtetasit M.K në territorin e shtetit shqiptar përkon me përfundimin e aktivitetit kriminal në Greqi.

Në kuadër të hetimit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kërkuar informacion nga bankat e nivelit të dytë, që operojnë në Republikën e Shqipërisë, për llogari bankare në emër të shtetasit M.K.

Në zbatim të detyrimit ligjor, Banka Popullore me Shkresën e saj Nr. xxxx/x datë 11.03.2010 ka informuar se shtetasit M.K dhe N.K kanë llogari bankare pranë saj. Në këtë llogari bankare, në datë 06.07.2009 është bërë një kreditim në shumën prej 70.000 euro, e deklaruar si e ardhur nga emigracioni. Sipas Kontratës së Sipërmarrjes Nr. XXXX Rep, Nr. XXX Kol datë 06.07.2009 ka rezultuar se shtetasi N.L.K ka porositur tek shoqëria ndërtuese XXXX SH.P.K, një apartament me sipërfaqe 99 m², ndodhur në katin e tretë të pallatit në Golem, kundrejt çmimit 70000

euro. Në datë 06.07.2009 shuma prej 70000 euro, nga llogaria bankare është transferuar në drejtim të shtetasit B.P, si pagesë për blerje apartamenti, sipas Deklaratës Nr. xxxx/xxx datë 06.07.2009.

Në kuadër të hetimit ka rezultuar se shtetësja B.K, bashkëshorte e shtetasit M.K, në datë 28.10.2009 ka blerë një apartament banimi tek Shoqëria “xxxxx” Sh.P.K, kundrejt çmimit prej 137.800 euro, shumë e cila është likujduar jashtë sistemit bankar. Nga përmbajtja e Kontratës së Sipërmarrjes Nr.XXXX Rep, Nr.xxxx Kol datë 28.10.2009 ka rezultuar se shtetësja B.K ka porositur tek Shoqëria XXX Sh.P.K, me ortak dhe administrator shtetasin M.S, një apartament banimi me sipërfaqe prej 106 m2 në pallatin e ndodhur në Rrugën “XXXXX” Tiranë.

Mbi kërkesën e prokurorisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin e saj Nr. XXX akti datë 29.03.2009 ka vendosur sekuestro preventive mbi pasuritë e përshkruara më sipër. Nga aktet bashkëngjitur kërkesës rezulton se ky vendim gjyqësor është vënë në ekzekutim me urdhërin e datës 09.04.2010, lëshuar nga prokuror Ardian Braho.

Nga kqyrja e dokumentacionit, ndodhur në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, ka rezultuar se shtetasi M.K është përdorues edhe i një automjeti tip Ford me targa XXXX.

Nisur nga fakti që shtetasi M.K dhe familjarët e tij nuk kanë ndonjë aktivitet tregëtar të rregjistruar dhe kanë deklaruar si burim të ardhurash emigracionin, prokuroria ka ngritur dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në prova (sipas saj) për kryerje, prej shtetasit M.K të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Gjithashtu duke çmuar se ndodhet para rasteve të parashikuara nga Ligji Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, materialin hetimor ja ka kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Në datë 09.06.2010 Prokuroria e Krimeve të Rënda ka paraqitur para kësaj gjykate, kërkesën me objekt sekuestrimin e pasurive të përshkruara hollësisht më sipër, duke patur si bazë ligjore Ligjin Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.

Gjykata, në respektim të kërkesave të nenit 12 pika 1 të ligjit në fjalë, brenda afatit ligjor pesëditor të parashikuar në këtë dispozitë, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën e paraqitur.

Në kërkesë dhe në seancë gjyqësore prokurori pretendoi:

1. Shtetasit M.K, N.K dhe B.K si dhe familjarët e tyre nuk kanë ndonjë aktivitet tregëtar të rregjistruar ndërkohë që ata i kanë deklaruar pasuritë e tyre si të ardhura nga emigracioni. Gjithashtu në momentin e hyrjes në Republikën e Shqipërisë, shtetasit M.K dhe B.K nuk kanë deklaruar para kesh në pikën e kalimit kufitar. Mbi bazën e këtyre rrethanave, (sipas prokurorit) ngrihet dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova, për kryerjen nga shtetasi M.K të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Duke qënë shtetasi M.K i dyshuar për kryerjen e një vepre të tillë ai, bashkëshortja e tij B dhe babai N janë subjekte të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “ Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

2. Vendosja e masës së sekuestros mbi llogaritë bankare dhe apartamentet e banimit, pavarësisht se mbi to është vendosur masa e sekuestros preventive, sipas prokurorit, është e domosdoshme pasi masa preventive është e varur plotësisht nga ecuria dhe mënyra e përfundimit të procedimit penal. Në këto kushte diktohet nevoja e ruajtjes së pasurive objekt sekuestrimi nga humbja ose tjetërsimi i tyre, parashikuar si kriter në nenin 11 pika 1 gërma “a” e Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009. Vendosja e masës së sekuestros mbi mjetin tip Ford, rregjistruar në emër të shtetasit M.K, diktohet nga ekzistenca e rrezikut real dhe potencial që kjo pasuri të tjetërsohet apo humbasë.

3. Pasuritë objekt sekuestrimi janë krijuar pas datës 25.06.2009, moment kur është kryer aktiviteti kriminal i shtetasit nën hetim M.K.

Gjykata në analizë të pretendimeve të prokurorit dhe provave të paraqitura prej tij, çmon se kërkesa e paraqitur është e drejtë, e bazuar ligj dhe prova dhe si e tillë duhet të pranohet për këto arsye:

I. Kërkesa është paraqitur në zbatim të nenit 3 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të titulluar “Fusha e zbatimit”.

Sipas pikës 1 të këtij neni, ligji gjen zbatim për pasuritë e personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicje për kryerjen prej tyre të një sërë veprash penale në të cilat përfshihet edhe vepra penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (gërma “d” e kësaj pike).

U provua në gjykim se shtetasi M.K është person në hetim për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprave penale”, për të cilën është duke proceduar Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Çelja e llogarisë bankare në emër të tij dhe familjarëve (konkretisht babait) me një shumë të konsiderueshme eurosh (70.000); blerja e dy apartamenteve me vlera të konsiderueshme dhe e një makine tip “Ford”; deklarimi i shumës së depozituar si të ardhura nga emigracioni; mungesa e ndonjë aktiviteti tregëtar të rregjistruar në emër të tij apo familjarëve; mungesa e deklarimit për para kesh në momentin e hyrjes së tij dhe bashkëshortes në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet pikës së kalimit kufitar; mosha e re dhe kryerja e transaksioneve dhe blerjeve në periudhën pas qershorit 2009 (kohë e kryerjes së aktivitetit kriminal në Greqi) çmohen nga gjykata si indicje të rëndësishme mbi bazën e të cilave ngrihet dyshimi për kryerje, nga shtetasi M.K, të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, vepër kjo e përfshirë në rrethin e veprave penale për të cilat bën fjalë pika 1 e ligjit.

Sipas pikës 2 gërma “a” të këtij neni, ligji zbatohet edhe për pasuritë e personave të afërm të subjekteve të pikës 1 të këtij neni.

Shtetasit, B.K dhe N.K, janë të afërm të shtetasit M.K, duke qënë B bashkëshortja e tij ndërsa N babai. Në kushtet kur shtetasi M.K (për sa u trajtuar më sipër) është subjekt i ligjit sipas pikës 1 të nenit 3 të tij, automatikisht edhe mbi pasuritë e bashkëshortes dhe babait të tij do të zbatohet ky ligj.

II. Në interpretim dhe zbatim të nenit 11 të ligjit, gjykata çmon se për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë është e domosdoshme ekzistenca njëkohësisht e dy kriterëve të përgjithshme që kanë të bëjnë me:

1. Ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicje që tregojnë se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale

2.Zotërimin e pasurive dhe të ardhurave që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre, si dhe

Ekzistencën e të paktës njërit prej kritereve të veçanta të parashikuara në pikat “a” dhe “b” të këtij neni.

Përsa më sipër u arsyetua se mbi shtetasin M.K rëndon dyshimi i arsyeshëm, i bazua në indicje, për përfshirje të tij në veprimtarinë kriminale të pastrimit të parave, (për të cilën është duke u hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë), që mund të jenë produkte të rrëmbimit të shtetases greke për të cilën ai dhe disa shtetas të tjerë janë duke u hetuar nga Prokuroria e Athinës. (kriteri 1 i përgjithshëm)

Shtetasi M.K dhe familjarët e tij nuk kanë të rregjistruar asnjë aktivitet tregëtar dhe asnjë të ardhur tjetër të ligjshme që të mund të justifikojë shumat e madhe të eurove të derdhura në llogari bankare apo të përdorura për të blerë apartamente në vlera të konsiderueshme dhe makinë. (kriteri 2 i përgjithshëm).

Ekziston rreziku real për tjetërsimin e pasurive, të lujtshme dhe të palujtshme pasi shtetasi M.K dhe të afërmit e tij janë vënë në dijeni të procedimit penal që është rregjistruar në ngarkim të tij dhe të masës së sekuestros preventive që është vendosur mbi pasurinë e tyre. Në këto kushte është e natyrshme që prej tyre të bëhen të gjitha përpjekjet për t’i tjetërsuar me qëllim shmangien nga një konfiskim i mundshëm dhe nxjerrjen e përfitimeve (kriteri i veçantë i parashikuar në pikën “a” të nenit 11).

Në bazë pikës 2 të nenit 14 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, ekziston detyrimi që gjykata të njoftojë zotëruarit e pasurive të sekuestruara për vendimin e marrë prej saj. Po në zbatim të kësaj dispozite, për realizimin e njoftimit zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 130, 131, 132 dhe 133 të Kodit të Procedurës Civile. Duke qënë se gjykata e gjeti kërkesën e paraqitur të drejtë dhe ligjore, vendimi saj duhet t’i njoftohet si shtetasit nën hetim M.K ashtu edhe personave të tretë B.K dhe N.K.

Në bazë të pikës 3 të nenit 14 dhe pikës 1 të nenit 15 të Ligjit në fjalë kompetentë për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit të pasurive janë përmbaruesit gjyqësorë dhe administratorët e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Në këto kushte është detyrim ligjor për gjykatën që në vendimin e saj të urdhërojë zyrën e përmbarimit, në juridiksionin e të cilës ndodhet pasuria e

palujtëshme (neni 516 i Kodit të Procedurës Civile) dhe, një administrator të agjensisë, të cilët do të koordinojnë punën për zbatimin e vendimit të sekuestros.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 3 pika 1 gërma “d” dhe pika 2 gërma “a”, nenit 7 pika 1 dhe 2, nenit 11 pika 1 gërma “a”, nenit 12 pika 1 dhe 2, nenit 14 pika 2 dhe 3, nenit 15 pika 1 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

V E N D O S I

1. Pranimin e kërkesës.

2. Vendosjen e sekuestros mbi pasuritë e mëposhtme:

1. Një apartament banimi, me sipërfaqe 106 m², ndodhur në katin e shtatë të pallatit në rrugën XXXX, Tiranë, përfituar nga shtetësja B.K me Kontratën e Sipërmarrjes Nr.XXX Rep, Nr XXX Kol, datë 28.10.2009 të lidhur me Shoqërinë XXXX Sh.P.K, me administrator shtetasin M.S.

2. Një apartament, me sipërfaqe banimi 99 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 9.9 m², ndodhur në katin e tretë të një pallati në XXXX, së bashku me garazhin, përfituar nga shtetasi N.L.K me Kontratën e Sipërmarrjes Nr. XXX Rep, Nr. XXX Kol, datë 06.07.2009, të lidhur me shoqërinë XXX Sh.P.K, me administrator shtetasin P.K.

3. Një mjet, tip Ford, me targa XXXX, rregjistruar në emër të shtetasit M.N.K në datë 05.01.2010, në Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë.

4. Një llogari bankare, çelur pranë Bankës Popullore, me Nr. XXXXX në emër të shtetasit M.N.K, në shumën 301. 064 (treqind e njëmijë e gjashtëdhjet e katër) lekë.

3. Për ekzekutimin e vendimit të sekuestros mbi pasuritë e palujtëshme (pika 1 dhe 2) dhe llogarisë bankare (pika 4) ngarkohen Zyrat e Përmbarimit Gjyqësor në Tiranë dhe Kavajë si dhe administrator M.H, në Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

4. Për ekzekutimin e vendimit të sekuestros mbi mjetin motorrik (pika 3) ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor Tiranë dhe administrator Ingrid

Domi, në Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

5. Urdhërohet K/sekretaria t'i njoftojë shtetasve M.K, B.K dhe N.K vendimin e sekuestrimit.
6. Kundër vendimit lejohet e drejta e ankimit të veçantë, brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

U shpall sot në Tiranë, në datë 11.06.2010

SEKRETARE

ANDINA KAJA

GJYQTARE

LILJANA BAKU